

VENDIM
Nr.1058, datë 21.10.2009

**PËR PËRCAKTIMIN E KUFIRIT MINIMAL TË REGJISTRIMIT PËR
TATIMIN MBI VLERËN E SHTUAR (TVSH)**

(Ndryshuar me VKM nr. 149, datë 3.3.2010)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5 të nenit 3 të ligjit nr.7928, datë 27.4.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Kufiri minimal i regjistrimit për tatimin mbi vlerën e shtuar (TVSH) të jetë 5 000 000 (pesë milionë) lekë, për vit kalendarik.

Ndërsa, për tatimpaguesit që ofrojnë shërbime në veprimtaritë e mëposhtme, kufiri minimal i regjistrimit për tatimin mbi vlerën e shtuar (TVSH) të jetë 2 000 000 (dy milionë) lekë, për vit kalendarik.

Veprimtaritë ekonomike, sipas profesioneve, janë:

- a) avokat, noter;*
- b) mjek i specializuar; dentist; dentist i specializuar; farmacist; infermier; mami; veteriner, arkitekt; inxhinier, mjek-laborant, projektues, ekonomist, agronom;*
- c) ekspert kontabël, i regjistruar, dhe kontabilist, i miratuar;*
- ç) vlerësues i pasurisë.*

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 janar 2010.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha